



UDHËZUES PËR PACIENTËT NË TERAPINË ME RREZATIM

ACIBADEM | SISTINA



Mirëserdhët

Në emër të gjithë personelit, kisha dashur t'ju dëshiroj mirëseardhje në Spitalin e klinikës “Acibadem Sistina” dhe Qendrën për onkologji dhe radioterapi. E zgjodhët qendrën më të mirë mjekësore, ku do të merrni kujdes dhe trajtim për të gjitha llojet e karcinomit. Ekipi ynë profesional dhe teknologjia më moderne do t'ju ofrojnë trajtim të sigurt dhe efikas. Secili nga mjekët tanë, i cili është i angazhuar t'ju mjekojë do t'ju përkushtohet tërësisht. Ai e di sëmundjen tuaj dhe do t'ua ofrojë trajtimin më të mirë.

Për diagnozën dhe mjekimin e karcinomit nevojitet mendim dhe vendim i përbashkët i specialistëve nga më shumë fusha. Kjo mënyrë e mjekimit, që ekspertët e definojnë si qasje shumë disiplinore, e rritën shkallën e suksesit gjatë diagnozës dhe mjekimit të karcinomit. Aparati më modern me të cilin disponojmë është Trilogy, një nga gjenerata më e re e aparateve në radioterapinë bashkëkohore.

Ofron targetim dhe rrezatim jashtëzakonisht preciz, me mbrojtje të njëkohshme të indit fqinj të shëndoshë. Gjatë trajtimit dhe

diagnozës i shfrytëzojmë edhe teknologjitë më cilësore diagnostifikuese për përpunimin e incizimeve, siç janë pozitron tomografia emetuese PET/KT dhe MRI funksionale (1.5 teslla), prej të cilave edhe të dyja janë shumë të ndjeshme dhe të vlefshme për diagnostifikimin e llojeve të caktuara të karcinomit.

Ne jemi të vetëdijshëm se shërbimi i shkëlqyeshëm për pacientin nuk varet vetëm nga teknologjia e avancuar dhe moderne, por gjithashtu është i rëndësishëm edhe kujdesi i personelit.

Ky udhëzues do t'ju japë të gjitha informatat dhe do të përgjigjet në pyetjet tuaja çfarë duhet të prisni gjatë terapisë me rrezatim. Çdo trajtim planifikohet në mënyrë individuale sipas nevojave tuaja, ndërsa ekipi ynë në mënyrë të hollësishme do t'ua sqarojë planin e mjekimit dhe trajtimin që do ta merrni.

Dr. Deva Petrova
Shef i Qendrës për onkologji
dhe radioterapi

ÇFARË ËSHTË TERAPIA ME RREZATIM?

Terapia me rrezatim është teknikë gjatë së cilës përdoret nivel i lartë i energjisë, X-rezeve. Të cilat i vrasin qelizat e karcinomit. Burimet e rrezatimit mund të jenë të jashtme, ku X-rrezet drejtohen nga karcinomi; ose të brendshme (nga brendia e trupit) dhe vijnë nga implanti radioaktiv.

Qëllimi i terapisë me rrezatim të jashtëm dhe të brendshëm është t'i vrase qelizat e kancerit, me mbrojtje maksimale të indit fqinj të shëndoshë rreth kancerit.

Terapia me rrezatim përdoret:

- Si trajtim i pavarur për mjekim
- Para operacionit që të zvogëlohet tumori
- Pas operacionit që t'i shkatërroje qelizat e kancerit, të cilat eventualisht kanë mbetur pas operacionit
- Bashkë me hemoterapinë, që i bënë qelizat e kancerit më të ndjeshme
- Pas hemoterapisë, që t'i vrase qelizat tjera të karcinomit
- Të kontrollohen simptomat siç janë dhimbjet ose gjakderdhja





GJATË TERAPISË ME RREZATIM

Gjatë terapisë me rrezatim nuk do ndjeni dhimbje. Tipi dhe doza e rrezatimit që do t'ua rekomandojë mjeku do t'i përshtaten diagnozës, llojit të karcinomit, stadiumit, madhësisë dhe lokalizimit të tumorit. Gjithashtu, gjendja juaj shëndetësore luan rol gjatë trajtimit.

Specialisti juaj i radioterapisë do të jetë në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë mjekët dhe bashkë do ta planifikojnë trajtimin, cili është më i miri për ju. Do të bisedojë me ju para fillimit të trajtimit dhe do t'i sqarojë efektet e mundshme të padëshiruara nga trajtimi.

Qendra për onkologji dhe radioterapi në Spitalin e klinikës "Acibadem Sistina" do t'ju japë të gjitha informatat që janë të domosdoshme që të informoheni mirë për planin tuaj për mjekim. Nëse keni pyetje plotësuese, ekipi ynë ju qëndron në dispozicion.








TERAPIA ME RREZATIM E TRILOGY

Terapia e jashtme me rrezatim është tipi më i shpeshtë i terapisë, gjatë së cilës me ndihmën e aparatit special, të quajtur akceleratori linear Trilogy, drejtohen doza të larta të X-rrezeve drejtpërdrejt në tumor. Akceleratori linear Trilogy mund ta ndryshojë pozitën dhe ta rrezatojë trupin tuaj prej më shumë këndeve. Me ndryshimin e këndit rrezatimi tërësisht e përfshinë pjesën që rrezatohet, ndërsa mbrohet indi i shëndoshë.





LLOJET E TERAPISË ME RREZATIM ME TRILOGY






Radio kirurgjia sterotaktike (SRS)

Radio kirurgjia stereotaktike (SRS) ka për qëllim në mënyrë të saktë dhe intensive ta drejtojë dozën e rrezatimit në rajonet e caktuara. SRS përdoret për rrezatim të pjesës ku gjendet tumori.

Kjo terapi me rrezatim mund të aplikohet edhe për mjekimin e tumoreve në pjesët e trurit të cilat nuk mund të operohen.

Ajo për çka veçohet SRS terapia me rrezatim nga aparatet tjera është se rrezet mund të orientohen drejt tumoreve shumë të vogla, pa e dëmtuar indin e shëndoshë rreth tumorit, dhe për dallim nga teknikat tjera, me SRS në mënyrë të njëhershme lëshohet dozë e lartë e rrezatimit.

SRS rrezet janë fokusuar vetëm mbi tumorin dhe nga drejtime të ndryshme lëshohet dozë e lartë e rrezatimit.



TERAPIA ME RREZATIM ME INTENSITET TË MODULUAR (IMRT)

Terapia me rrezatim me intensitet të moduluar (IMRT) aplikohet për shpërndarjen më të mirë të dozës, do të thotë tumori e pranon dozën e rekomanduar, ndërsa indet dhe organet e shëndosha mbrohen në mënyrë maksimale. Akceleratori linear lëvizë nën kënd të caktuar dhe e orienton gjithë intensitetin e rrezatimit në pjesë të ndryshme të tumorit të trajtuar. IMRT përdoret për mjekimin e tumoreve të: trurit, kokës dhe qafës, mushkëritë dhe prostatën.

TERAPIA ME RREZATIM E UDHËHEQUR NGA INCIZIMET (IGRT))


Terapia me rrezatim me IGRT mundëson caktimin e lokacionit të tumorit gjatë trajtimit. Duke iu falënderuar incizimeve kontrolluese të përditshme, përcillet nëse tumorin që e rrezatojmë është në

fushën e rrezatimit. Pacienti incizohet jo vetëm para por edhe gjatë terapisë, me çka mundësohet pengimi në kohë i zhvendosjeve eventuale të tumorit gjatë trajtimit.

EKIPI PËR RADIOTERAPI

Ekipi ynë është i përbërë prej mjekëve specialistë dhe ekipit mjekësor nga fusha të ndryshme. Secili prej tyre ka përvojë të madhe në punë, që ka të bëjë edhe me trajnimet e shumta në qendrat e njohura botërore onkologjike, me qëllim që t'ju mundësojnë diagnozë cilësore dhe trajtim për tipin tuaj të karcinomit.

Ekipi do të punojë bashkë me ju, ndërsa ju do të jeni të sigurt se e merrni trajtimin më efikas me rrezatim. Ata do të jenë me ju gjatë gjithë terapisë dhe do t'ju japin mbështetje maksimale në betejën me sëmundjen tuaj. Bashkë do ta ndjekin përparimin tuaj dhe do t'u përgjigjen në çdo pyetje.





EKIPI YNË ËSHTË I PËRBËRË NGA:

- **Specialistë të radioterapisë dhe onkologjisë** – mjek të cilët kanë specializuar për mjekim të karcinomit. Bashkë me ju dhe me ekipin tjetër të mjekëve, ata do ta përgatisin planin tuaj për mjekim. Radio-onkologu është përgjegjës për caktimin e dozës dhe tipin e rrezatimit, por edhe për përcjelljen e efekteve gjatë mjekimit.
- **Motra medicinale për onkologji rrezatuese** – Motra medicinale është e angazhuar për kujdesin e pacientit para, gjatë dhe pas trajtimit. Ajo do të jetë këtu dhe do t'i përgjigjet çdo pyetjeje tuajën ose brengën që e keni. Do të kujdeset që me kohë ta pranoni terapinë e caktuar nga meku dhe do t'ju ndihmojë të ballafaqoheni me simptomat e sëmundjes.
- **Teknologu radiologjik** – është personi i cili është përgjegjës për dhënien e dozës ditore të trajtimit të rrezatuar dhe zbatimin e tij me saktësi.
- **Fizikani mjekësor** – ky anëtar i ekipit është përgjegjës për pjesën teknike të trajtimit dhe mjekimit. Ai e llogaritë dozën dhe planin e rrezatimit, i cakton këndet e rrezatimit që kanë më adekuate. Është përgjegjës edhe për kalibrimin, funksionimin dhe sigurinë e pajisjes.

SIGURIA DHE KUALITETI

Qendra për onkologji dhe radioterapi në Spitalin e klinikës “Acibadem Sistina” siguron siguri maksimale dhe kualitet.

E mirëmbajmë rregullisht dhe e kalibrojmë pajisjen në bazë ditore, me çka kujdesemi për sigurinë tuaj të tërësishme.



Plani juaj për mjekim është nën mbikëqyrje të vazhdueshme të ekipi tonë, rregullisht ndiqen efektet dhe procesi i mjekimit. Përmes kontrolleve të rregullta dhe incizimeve bëhet kontrolli nëse e merrni dozën e caktuar dhe ilaçet. Protokollet sipas të cilave zbatohet terapia me rrezatim janë në pajtim me standardet më të larta në shëndetësi – JCI.

PLANIFIKIMI I TRAJTIMIT TUAJ - SIMULIMI

Gjatë planifikimit të trajtimit radioterapeutik të pacientëve, përdoret TK simulimi, me çka mundësohet shënimi i saktë i tumorit dhe organeve të shëndosha, që ka rëndësi të veçantë për rritjen e suksesit nga mjekimi, ndërsa në të njëjtën kohë edhe zvogëlimi i efekteve të padëshiruara nga terapia. Simulimi përbëhet nga skanimi me tomografi kompjuterike (TK) në regjionin specifik ku gjendet tumori. Akceleratori linear TRILOGY është aparati i vetëm në regjion që mundëson kontroll të shkëlqyeshëm të kualitetit të rrezatimit me shfrytëzimin e CBCT (con bin CT).

Pas procesit të simulimit, mjeku juaj do ta markojë ven-

din që duhet të rrezatohet. Këto shenja ose tatuazhe janë shumë të rëndësishme pasi që ata mundësojnë që ekipi ynë ta caktojë pozitën e rrezatimit në çdo trajtim. Mos i hiqni dhe fshini pjesët e markuara gjatë trajtimit. Një pjesë e simulimit ose planifikimit të sesionit është që të gjendet edhe pozita e rregullt dhe më e mirë e trupit gjatë trajtimit. Për këtë qëllim, ekzistojnë mjete speciale dhe maska për imobilizim, të cilat do t’ju ndihmojnë që ta mbani trupin në pozitë konstante dhe të drejtë gjatë trajtimit. Pas simulimit, fizikanët me urdhër të mjekut do ta përgatisin planin për rrezatim. Pasi të përgatitet plani, trajtimi juaj mund të fillojë.



Plani për mjekim i përmban informatat që vijojnë:

- Pse plani për mjekim i propozuar për ju është zgjidhja më e mirë për ju
- Çfarë është ajo që mund dhe nuk mund të bëhet gjatë mjekimit
- Informata për llojin dhe kohëzgjatjen e terapisë me rrezatim
- Si realizohet trajtimi
- Cilat janë efektet e padëshiruara nga trajtimi

Kur do të përgatitet plani për mjekim para trajtimit të parë, mjeku do të kërkojë nga ju të nënshkruani formularin me pëlqim për mjekim.




ÇFARË PRITNI NGA TRAJTIMI ME RREZATIM?

Vizita juaj e parë e onkologut është vizitë konsulentë. Mjeku do t'i shqyrtojë ekzaminimet tuaja të deritanishme, do të bëjë kontroll fizik dhe do t'ju këshillojë për trajtim të mëtejshëm. Është e domosdoshme që ta informoni mjekun për ilaçet të cilat i pranoni dhe për dozën e tyre. Informojeni edhe rreth asaj nëse jeni alergjik ndaj një ilaçi të caktuar, ose jeni shtatzënë, që

t'i ketë parasysh të gjitha informatat. Ekipi ynë do të jetë partneri juaj në procesin e mjekimit. Ekipi ynë do të jetë partner në procesin e mjekimit. Do t'ju ndihmojë që më lehtë t'i kaloni momentet e vështira dhe do të jetë mbështetja juaj. Gjatë konsultimeve, ai do t'ju informojë gjatë mjekimit, trajtimeve, dozën e rrezatimit, si dhe për efektet e mundshme të padëshiruara.

ORARI I MJEKIMIT

Kohëzgjatja e rrezatimit, si dhe numri i trajtimeve janë të ndryshme për çdo pacient. Shumica e pacientëve pranojnë vetëm një terapi me rrezatim në ditë, por disa pacientë marrin edhe nga dy trajtime në ditë. Para fillimit të terapisë mjeku juaj do ta bëjë vlerësimi për numrin e trajtimeve që ju nevojiten. Ndonjëherë numri i trajtimeve varet edhe nga rrjedha e mjekimit. Forma e jashtme e rrezatimit, zakonisht, jepet në doza të vogla gjatë një periudhe, nga një ditë deri në disa javë. Me këtë u jepet mundësi qelizave normale të shëndoshen. Për shumicën e pacientëve, trajtimet me rrezatim jepen çdo ditë, pesë herë në javë (e hënë – e premte). Orari i rrezatimit do të organizohet sipas kohës suaj të lirë.





PROCESI I MJEKIMIT

Në Qendrën për onkologji dhe radioterapi në Spitalin e klinikës “Acibadem Sistina” ekzistojnë ambiente të veçanta – dhoma për zhveshje, ambienti ku mund t’i leni gjërat personale. Ju lutemi, që gjërat e çmuara t’i lini në shtëpi!

Varësisht nga lokalizimi i pjesës që trajtohet, nga ju do të kërkohet t’i vishni pizhamet e spitalit. Anëtarët e afërt të familjes mund t’ju shoqërojnë gjatë trajtimeve. Ata mund të rrinë në dhomën për pritje derisa ju gjendeni në trajtim.

Të gjitha dhomat për trajtim janë private me qëllim që t’ju ndihmojnë që të relaksohuni. Me ju mund të merrni muzikën e preferuar, të cilën do ta dëgjoni gjatë trajtimit.

Para fillimit të trajtimit teknikët tanë edhe një herë do ta kontrollojnë funksionimin e aparatit, me të cilin do të rrezatohen. Përsëri do të markohen pjesët që duhet të rrezatohen dhe do të evidentohen në historinë tuaj. Nëse për trajtimin ju nevojitet maskë ose mjet tjetër për imobilizim, tekniku do t’ju ndihmojë rreth pozitës së drejtë. Para se të fillojë rrezatimi, tekniku do ta braktisë ambientin, por me ndihmën e mikrofonit do të mund të komunikojë me ata gjatë terapisë. Mbani mend, terapia me rrezatim është e padhembshme. Nëse nuk ndjeheni këndshëm për ndonjë shkak, ndani frikën tuaj me ekipin tonë. Gjatë terapisë merrni frymë normalisht. Do të informoheni kur do të përfundojë trajtimi dhe mund ta braktisni ambientin për rrezatim dhe të ktheheni në aktivitetet tuaja të përditshme.

SI DO TË NDJEHENI PAS TRAJTIMIT ME RREZATIM?

Terapia me rrezatim nuk dhemb. Mund të ndodh që aspak mos ta ndjeni rrezatimin. Megjithatë, mund të paraqiten efekte të padëshiruara nga radioterapia. Mjeku juaj do të bisedojë me ju për këto efekte të padëshiruara para mjekimit tuaj.



KONTROLLI I EFEKTEVE NGA TRAJTIMI

Specialisti ynë i onkologjisë dhe radioterapisë do t'i përcjellë efektet nga trajtimi me rrezatim. Gjatë trajtimit, ndoshta do të nevojitet që të bëhet në mënyrë plotësuese:

- kontrolli fizik
- teste për kontrollin e gjakut
- ndryshime të caktuara në planin e mjekimit
- t'ju japë ilaçe plotësuese

Në këto konsultime kur mjeku do t'i ndjeke efektet nga mjekimi, mund të kërkonit që mjeku t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve që i keni. Nëse dëshironi të merrni terapi plotësuese, vitamina ose ilaçe prej bimëve me vendimin tuaj, duhet ta informoni mjekun tuaj.

PAS PËRFUNDIMIT TË TRAJTIMIT

Kur do të përfundojë trajtimi juaj i rrezatimit, mjeku do të përgatisë raport të plotë për gjendjen tuaj shëndetësore pas mjekimit. Efektet nga rrezatimi mund të zgjatin disa javë ose muaj pas përfundimit të mjekimit tuaj. Është e rëndësishme që ta informoni mjekun tuaj nëse keni ndonjë simptomë ose problem pas përfundimit të rrezatimit.

EFEKTET E PADËSHIRUARA NGA TERAPIA ME RREZATIM

Qëllimi i terapisë me rrezatim është të shkatërrohen qelizat kanceroze, por ndonjëherë gjatë mjekimit mund të paraqiten edhe efekte të padëshiruara. Me trajtimin në kohë të efekteve të padëshiruara, ato mund të zhduken në javën e parë nga rrezatimi. Lodhja, humbja e oreksit dhe irritimi i lëkurës janë efektet më të shpeshta të padëshiruara.

Gjithmonë informoni mjekun dhe personelin mjekësor për efektet e padëshiruara. Ata do t'ju informojnë se si të ballafaqoheni në mënyrë të dejtë me ato.



KUJDESI I LËKURËS GJATË TERAPISË ME RREZATIM

Reagimet e lëkurës janë të zakonshme gjatë terapisë me rrezatim. Ju lutemi që t'i ndiqni këto këshilla për kujdesin e lëkurës:

- Pas trajtimit lani me kujdes lëkurën në pjesën që ka qenë e rrezatuar me ujë të ngrohtë dhe me sapun
- Kremi për kujdes të lëkurës mund t'i përdorni 2 deri 3 herë në ditë (në mëngjes, në mesditë dhe në mbrëmje)
- Mos përdorni preparate plotësuese kozmetike në lëkurë në pjesën e trajtimit. Për shembull, losion, parfum ose grim
- Përdorni vetëm brisk elektrik në pjesën e trajtuar
- Vishni rroba të lehta që nuk do t'ju ngushtojnë në pjesën e rrezatuar
- Vishni rroba nga pëlhura të buta si pambuku
- Mbrojeni lëkurën tuaj nga dielli
- Mbani kapelë dhe syza, të cilat do t'ju mbrojnë nga dielli





USHQIMI

Është e mundur të vëreni në ndryshime në oreksin tuaj gjatë terapisë me rrezatim. Kini kujdes se çfarë hani, ushqimi i shëndetshëm d t'ju ndihmojë t'i zvogëloni efektet e padëshiruara nga terapia me rrezatim. Hani ushqim që është i pasur me proteina dhe kalori për mbajtjen e peshës dhe energjisë suaj. Gjithmonë duhet të konsultoheni me mjekun tuaj ose motrën medicinale para se të merrni vitamina ose shtojca tjera. Gjatë mjekimit, mund të nevojitet konsultim me nutricionistin.

HUMBJA E FLOKËVE

Kur realizohet terapia me rrezatim te tumoret në kokë, mund të vijë deri te humbja e flokëve (alopeci). Te shumica e pacientëve flokët do të rriten disa muaj pas trajtimit. Flokët tuaj mund të jenë të ndryshme sipas ngjyrës dhe kualitetit. Nëse edhe me çfarë intensiteti do të rritet, varet nga regjioni i trajtuar dhe numri i trajtimeve.

LODHJA


Është normale të ndjeni lodhje pas trajtimit dhe të mos keni energji. Trupi juaj punon me shumë mund që të shëndoshet dhe të kthehet në normale. Të siguroheni se flini mjaft gjatë natës. Bisedoni me mjekun tuaj ose motrën medicinale nëse nuk keni kondicion të mjaftueshëm. Nëse punoni me orar të plotë pune, ndoshta do të duhet të bisedoni me eprorin tuaj që të punoni me orar të shkurtuar pune ose një pjesë të obligimeve t'i kryeni nga shtëpia. Kërkoni nga anëtarët e familjes t'ju ndihmojnë rreth obligimeve në shtëpi. Ndonjëherë ushtrimet e lehta, si ecja, mund të bëhen të ndjeheni më mirë. Pyetni mjekun tuaj ose motrën medicinale që të filloni me programin për ushtrim.

AKTIVITETI SEKSUAL

Mund të jeni seksualisht aktiv gjatë terapisë me rrezatim, por duhet të përdorni mbrojtje nga shtatzënia. Ndjenja e lodhjes mund ta zvogëlojë interesin dhe dëshiruan tuaj për aktivitet seksual.







FERTILITETI – GJATË DHE PAS TRAJTIMIT

Për femrat

Nëse tashmë jeni shtatzënë ose dyshoni se jeni shtatzënë, informoni mjekun tuaj para fillimit të radioterapisë. Nuk rekomandohet që gjatë trajtimit të mbeteni shtatzënë, pasi që terapia me rrezatim mund të ndikojë negativisht mbi frytin dhe zhvillimin e tij. Radioterapia mund të ndikojë në pjellshmërinë tuaj të ardhshme. Nëse planifikoni të keni fëmijë në të ardhmen, flisni me mjekun tuaj për mundësitë për ngrirjen e qelizave vezë.

Për meshkujt

Radioterapia në regjionin e testiteve mund ta zvogëlojë numrin dhe funksionin e spermatozoideve, me ka mund të ndikojë në fertilitetin tuaj të ardhshëm. Nëse jeni të brengosur lidhur me fertilitetin tuaj, duhet të mendoni për ngrijën e spermës para fillimit të trajtimit.

Ndjenjat dhe brengat

Nëse ju është vendosur diagnoza e kancerit, është normale që ju edhe anëtarët e familjes suaj të ndjehen të brengosur. Çdo njeri reagon ndryshe ndaj diagnozës dhe mjekimit të kancerit. Shmanguni situatave me stres, bisedoni me të afërmit tuaj dhe mjekët rreth asaj se si ndjeheni.

Këshilla të dobishme

- Arrini në Qendrën për onkologji dhe radioterapi 15 minuta para kontrollit të caktuar
- Merrni me vete të gjitha dokumentet e nevojshme dhe ekzaminimet
- Kërkoni instruksione për planin e mjekimit
- Kërkoni këshillë për pengimin e efekteve të padëshiruara



ACIBADEM | SISTINA

www.cancertreatment.mk

call center
((02 3099 500))
www.acibademsistina.mk

Skupi 5A, 1000 Shkup, Maqedoni